



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT  
FACULTY OF LIFE AND ENVIRONMENTAL SCIENCES

 <b>Universiteti i Prizrenit</b> Univerziteti Prizren Prizren Universiteti <b>"UKSHIN HOTI"</b> F. i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Pranuar me dt. <b>06.03.2024</b>	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
<b>507</b>	<b>01-52</b>

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29 232 140; Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Lënda:** Kryerja e Praktikës Profesionale për Studentët e nivelit bachelor "Agrobiznes" dhe master "Menaxhim në agrobiznes" të Fakultetit të (më tej FSHJM të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (më tej Universiteti)

### NENI 1

Institucioni/Ndërmarrja **SARAY SWEETS** e përfaqësuar nga Z/Zj **EMIR SHABANI** me detyrë **DREJTOR EKZEKUTIV** dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) përfaqësuar nga Prof. Asoc. Dr. Albana Milaimi, Dekane i ketij Fakulteti, lidhin me vullnet të lirë këtë kontratë.

### NENI 2

**Institucioni/Ndërmarrja merr persiper:**

1. Të presë, të asistojë teknikisht dhe të monitorojë për një semestër të vitit akademik studentin/tët duke caktuar një nga punonjesit e vet si udhëheqës të tij. Udhëheqësi të jetë një specialist me përvojë sa më të madhe të jetë e mundur dhe sa më afër profesionit të studentit dhe objektivave të praktikës.
2. Të krijojë sa të jetë e mundur kushte lehtësuese, si vendqëndrim të përkohshëm në një zyrë, transport brenda zonës së praktikës brenda mundësive duke shfrytëzuar udhëtimet e automjeteve të veta për qëllime pune.
3. Të vlerësojë me shkrim punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit, duke u ndalur veçanërisht në përfitimet e realizuara prej tij dhe në sugjerimet për fakultetin me qëllim përmirësimin e praktikës së studentëve të tjerë në të ardhmen.

Vlerësimi i përcillet zyrtarisht fakultetit në fund të punës praktikës.

### NENI 3

Gjatë kohës së punës praktikës studenti zbaton orarin dhe detyrat që i cakton udhëheqësi në përputhje me kërkesat e programit të praktikës dhe me përmbajtjen e kësaj kontrate.

### NENI 4

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) merr përsipër:

1. Të dërgojë studentin/tët e FSHJM në praktikë në afatin e caktuar.
2. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me ndërmarrjen për problemet eventuale dhe për ecurinë e praktikës.
3. Të kontrollojë herë pas here procesin e kryerjes së praktikës nga studenti me qëllim të dhënies së ndihmës dhe rritjen e efektivitetit të saj.
4. Të vlerësojë praktiken e kryer nga studentët në përfundim të saj.

### NENI 5

Mosmarreveshjet eventuale midis palëve do të zgjidhen me bashkëbisedim ose konsensus të dyanshëm.

U lidh me datën 28/02/2024

Për Institucionin//Ndërmarrjen

Për Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

**SARAY SWEETS SH.P.K**

**DREJTORI**

**EMIR SHABANI**



**DEKANI**

**Prof. Asoc. Dr. Albana Milaimi**

